

Vendim nr. 113 datë 02.05.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, në datën 02.05.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (Sh)/1 2025 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: QENDRA “CENTRE FOR LEGAL EMPOWERMENT”, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Franc Terihati.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok”, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 në datën 07.03.2025, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok””, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 në datën 07.03.2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 22, 23, 45, 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h” dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, pika 1, 26, pika 1, 139, pika 2, 174 e 177, pika 5, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 32, pika 4, 32/1, 42 e 46 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 27, pika 4 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ka miratuar vendimin nr. 151, datë 06.03.2025 “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *on-line* “TikTok”” (VKM nr. 151/2025). Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 07.03.2025 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit në këtë fletore.

2. VKM-ja nr. 151/2025 ka parashikuar ndërprerjen e aksesit në platformën *on-line* “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 12 muaj, me qëllim shmangien e ndikimeve negative dhe të problematikave sociale në tërësi, kryesisht në nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, që sjellin probleme të zhvillimit psikosocial të tyre, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale (*pika 1*). Ndërprerja e kësaj platforme zgjat deri në mundësimin, nga ofruesi i kësaj platforme, të instrumenteve teknike që rregullojnë aksesin e fëmijëve në këtë platformë dhe në materiale të dëmshme për ta (*pika 2*). Në vijim, VKM-ja ka caktuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit së bashku me autoritetet rregullatore sektoriale për të komunikuar e negociuar me përfaqësuesit e platformës dhe me përfaqësues të platformave të tjera *on-line* për të adresuar problematikat në fushën e sigurisë publike dhe sociale në mjedisin digjital, duke përfshirë: a) operimin efektiv të sistemeve funksionale të verifikimit të moshës së përdoruesve të platformës; b) operimin e sistemeve të kontrollit prindëror lidhur me përmbajtjet që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijëve; c) shmangien e publikimit të materialeve me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhe urrejtjeje ose me fjalor të papërshtatshëm; ç) përshtatjen e përdorimit të filtrave të moderimit për gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare (*pika 3*).

3. Kjo VKM ka parashikuar gjithashtu detyrimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me entet rregullatore të fushës, të marrë masat e nevojshme për realizimin e ndërprerjes së aksesit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi (*pika 4*) dhe pasi të realizohet nga platforma vendosja e filtrave të nevojshëm, mund të vendosen masa të reja ose

të rishikohen masat në fuqi (*pika 5*). Së fundi, për sa i përket zbatimit, VKM-ja ka ngarkuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe autoritetet rregullatore sektoriale (*pika 6*).

4. Në datën 19.03.2025 shoqata “Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë”, qendra “Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative, Shqipëri - Balkan Investigative Reporting Network, Albania” (*qendra BIRN, Albania*) dhe qendra “Centre for Legal Empowerment” (*qendra CLE*) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.04.2025.

5. Me vendimin e datës 25.04.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 02.05.2025, bazuar në nenin 19 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur ndarjen e çështjes dhe shqyrtimin veçmas të kërkesës së kërkuës. Për sa u përket dy kërkuësve të tjerë, me vendim të po kësaj date, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

II

Pretendimet e kërkuës

6. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

6.1. Gjykata ka juridiksion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi VKM-ja nr. 151/2025 zbatohet në të gjithë territorin dhe u drejtohet të gjithë përdoruesve të platformës *on-line* “TikTok”, qoftë aktualë ose potencialë.

6.2. VKM-ja duhet të pezullohet pasi ajo ka ndikim në lirinë e veprimtarisë ekonomike, lirinë e shprehjes, të shtypit dhe të drejtën për informim si dhe krijon efekte të pariparueshme dhe të drejtpërdrejta në sektorë të ndryshëm.

6.3. Kërkuësja legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës pasi është regjistruar si person juridik dhe gëzon personalitet juridik, VKM-ja ka prekur interesa të drejtpërdrejta dhe objektin e veprimtarisë të parashikuar në statut si dhe kërkesa është paraqitur brenda afatit dy-vjeçar.

6.4. *Për themelin e çështjes:*

Zbatimi i VKM-së nr. 151/2025 ka cenuar:

6.4.1. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të parashikuar në nenin 11, pika 3, të Kushtetutës, pasi kufizimi i aksesit në këtë platformë kufizon lirinë e shprehjes;

shkakton humbje të konsiderueshme financiare, duke u kufizuar mundësinë bizneseve për të arritur audiencën e tyre pa pagesa të konsiderueshme reklamash në mediat tradicionale, si dhe dëmton sektorët e teknologjisë, turizmit, artizanët, industrinë e muzikës, të ushqimit dhe restorantet. Këta sektorë do të kenë pasoja negative në zhvillimin e tyre dhe në të ardhurat e profesionistëve të përfshirë në to; do të ketë rënie të ndjeshme të ekspozimit për destinacionet turistike më pak të njohura, sepse do të kufizohet mundësia për promovim pa kosto për operatorët turistikë dhe do të ketë ndikim drejtpërdrejt në reduktimin e të ardhurave të bizneseve që varen nga promovimi në këtë rrjet social. Ndërhyrja nuk ka plotësuar kriteret kushtetuese të kufizimit të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në drejtim të kriterit “vetëm me ligj”, asnjë dispozitë e ligjeve, mbi bazën e të cilave ka dalë VKM-ja nr. 151/2025, nuk urdhëron nxjerrjen e një akti të tillë nënligjor që synon ndërhyrje në një fushë të caktuar të komunikimit elektronik dhe kufizimin të një kategorie të gjerë përdoruesish të internetit. Në këtë kuptim është cenuar edhe parimi i hierarkisë së normave juridike, pasi akti nuk ka dalë në bazë dhe për zbatim të një ligji dhe nuk ka pasur një autorizim të shprehur nga ana e ligjvënësit. Për sa i përket kriterit të “interesit publik”, nuk provohet rreziku i qartë dhe konkret për interesin publik nga një masë kaq ekstreme. Ndërsa lidhur me kriterin e proporcionalitetit, masa është e ashpër dhe e menjëhershme, ndalimi është i përgjithshëm, pasi prek një kategori të gjerë përdoruesish dhe jo vetëm fëmijët, si dhe mbrojtja e të dhënave personale mund të realizohet me masa më pak të ashpra. Po kështu, nuk justifikohet objektivi që synohet të arrihet.

- 6.4.2. *Lirinë e shprehjes, të shtypit dhe të drejtën për informim*, pasi VKM-ja kufizon në mënyrë të përgjithshme dhe të pakushtëzuar aksesin e qytetarëve, gazetarëve dhe bizneseve në një nga hapësirat kryesore dhe më gjithëpërfshirëse të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në epokën digjitale. Ndalimi i platformës përbën një ndërhyrje të pajustificuar, e cila nuk i përmbush kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. VKM-ja zgjedh të ndalojë tërësisht një rrjet social të përdorur nga mijëra qytetarë, në vend që të synojë përmbajtjen specifike që mund të konsiderohet problematike brenda platformës. Kjo masë shkon përtej nevojës për të mbrojtur sigurinë publike ose interesin publik dhe përbën një kufizim joproporcional dhe të panevojshëm. Një masë alternative do të ishte zbatimi i rregullave të përmirësimit të përmbajtjes ose forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes. Platforma “TikTok” është një mjet i rëndësishëm

për gazetarët dhe mediat e pavarura, veçanërisht në një kohë ku informacioni shpërndahet nëpërmjet rrjeteve sociale. Për gazetarët dhe organizatat e medias ndalimi i një platforme të tillë do të thotë humbje e një kanali të rëndësishëm për të shpërndarë lajme, për të komunikuar me audiencën dhe për të nxitur debatin publik. Gjithashtu, cenohet edhe liria e informimit, pasi ndalohen qytetarët të kenë akses në informacionin që shpërndahet përmes kësaj platforme.

- 6.4.3. *Parimin e shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi situata e përdoruesve të platformës rëndohet ndjeshëm deri në cenimin e plotë dhe në thelb të të drejtave dhe lirive të tyre, veçanërisht e atyre që e përdorin platformën për qëllime ekonomike, informuese dhe profesionale. VKM-ja nuk ka parashikuar asnjë periudhë tranzicioni, duke i lënë përdoruesit e platformës në një gjendje paqartësie dhe pamundësie efektive për të përshtatur aktivitetet e tyre në mënyrë të rregullt dhe pa pasoja kaq të rënda, duke ndikuar te bizneset, mediat dhe qytetarët. Për bizneset ajo krijon një problem serioz të paqëndrueshmërisë ekonomike dhe pasojave financiare, duke i lënë në një situatë pasigurie për të ardhmen ekonomike dhe profesionale. Po kështu, ndalimi i platformës ka rezultuar me humbje të të dhënave të akumuluar ndër vite dhe pa një mekanizëm mbrojtës ose kompensues. Për sa i përket medias, ky vendim dëmton procesin e ndërtimit të audiencës dhe angazhimit me publikun, pasi nuk është dhënë asnjë kohë e mjaftueshme për krijimin e kanaleve alternative të shpërndarjes së përmbajtjes dhe komunikimit me ndjekësit.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuës

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr.14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

8. Për legjitimitimin e organizatave, si subjekte që e vënë në lëvizje, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës ato legjitimohen për t’iu drejtuar Gjykatës për pajtueshmërinë e normës me Kushtetutën

vetëm nëse përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka theksuar se në çështje të kontrollit kushtetues të normës organizata duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe normës që kundërshton. Vetëm fakti se akti i kundërshtuar mund të ketë ose ka pasur një efekt çfarëdo për kërkuesen, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ajo legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka ose jo mjaftueshëm interes për vënien në lëvizje të saj për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja, qendra CLE, është person juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1662, datë 14.12.2021 dhe vepron si organizatë jofitimprurëse, pa anëtarësi. Sipas nenit 4 të statutit, qëllimi i qendrës është fuqizimi ligjor i qytetarëve për të njohur, kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike parësore, dytësore etj., të shërbimeve ligjore dhe financiare, pjesëmarrjes në procedurat e konsultimit të legjislacionit, organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve dhe hartimi e publikimi i studimeve në fushën e drejtësisë etj. Objekti dhe fushat kryesore të veprimtarisë janë të drejtat themelore të njeriut; mbrojtja e mjedisit; të drejtat në punë, të konsumatorit, pronësisë dhe strehimit; përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga pushteti qendror dhe lokal; mbrojtja e vajzave dhe grave, fëmijëve, komunitetit rom dhe egjiptian, gazetarëve, aktivistëve, studiuesve ose çdo personi të angazhuar në sferën publike; mbrojtja nga diskriminimi; shpërblimi i dëmeve kontraktore dhe jashtëkontraktore; ndihma juridike parësore, dytësore; ndërmjetësimi dhe arbitrazhi; mbështetja ligjore për nisma të qytetarëve, komuniteteve dhe subjekteve juridike; ndërmarrja e nismave individuale për adresimin e problematikave të mësipërme dhe përfaqësimi i këtyre subjekteve në gjykatë; ofrimi i konsulencës në fushën e legjislacionit dhe zgjidhjeve inovative në përballje me ndryshimet

klimaterike dhe aftësi i aktorëve lokalë në tranzicionin e energjisë; ndërmarrja e veprimtarive për përfaqësimin, mbrojtjen, promovimin etj. të të drejtave të të rinjve; analiza e studime ligjore ose në fushën ekonomiko-sociale për të nxituar apo promovuar nismat ligjore ose të krijimit dhe forcimit të institucioneve që u shërbejnë qytetarëve, komuniteteve dhe personave juridikë, si dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe të drejtave konsumatore. Anëtarë themelues janë katër shtetas shqiptarë.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve, duke vlerësuar legjitimitimin e kërkueses si organizatë pa anëtarësi dhe, për këtë arsye, vetëm në drejtim të objektit të veprimtarisë së saj të lidhur me të drejtat kushtetuese të pretenduara të cenuara, vlerëson se qëllimi i saj është tepër i gjerë dhe i hartuar në terma të përgjithshëm. Kërkuessa nuk ka paraqitur asnjë provë ose argument në drejtim të veprimtarisë së saj të lidhur me kategori të posaçme apo të drejtat kushtetuese që synon të mbrojë përmes ankimit kushtetues dhe as të mënyrës së përfaqësimit të kategorive të prekura nga zbatimi i aktit të kundërshtuar. Kjo kërkuessa nuk ka arritur të provojë në terma konkretë përpara Gjykatës as ushtrimin e veprimtarisë së saj në drejtim të mbrojtjes gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo synon të mbrojë ose të përcaktojë ndikimin dhe cenimin konkret të të drejtave të tyre nga zbatimi i aktit të kundërshtuar në drejtim të pasojave të drejtpërdrejta e reale ose potenciale të shkaktuara këtyre interesave. Edhe nëse do të pranohej se VKM-ja e kundërshtuar prek atë pjesë të veprimtarisë së kërkueses që synon mbrojtjen e gazetarëve, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ajo nuk ka arritur të provojë konkretisht cenimin e veprimtarisë së saj praktike në këtë drejtim. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se veprimtaria e kërkueses nuk rezulton të jetë e lidhur mjaftueshmërisht me normën e kundërshtuar, në një masë të tillë që ta legjitimojë atë në kërkesën e saj sipas objektit.

12. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuessa nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues të VKM-së nr. 151/2025.

13. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkesa e paraqitur nga qendra CLE nuk plotëson kriteret për kalimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të kërkesës së paraqitur nga kërkuuesja, qendra “Centre for Legal Empowerment” (qendra CLE) për shfuqizimin e VKM-së nr. 151/2025, përmes së cilës është kufizuar aksesit në platformën online “TikTok”, jam kundër qëndrimit të shumicës për moskalimin e çështjes në seancë plenare, pasi vlerësoj se kërkesa përmbush kriteret paraprake të pranueshmërisë. Për të njëjtat argumente që kam shprehur edhe në mendimin e pakicës, që shoqëron vendimin nr. 140, datë 26.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, për (mos)legjitimitimin e dy organizatave të shoqërisë civile për kundërshtimin e një akti normativ, çmoj se edhe në rastin në shqyrtim kërkuuesja legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues sipas objektit të kërkesës, e cila duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në arsyetimin e mëposhtëm.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se në datën 01.04.2025 kërkuuesja, së bashku me dy organizata të tjera, i është drejtuar Gjykatës me të njëjtën kërkesë për shfuqizimin si antikushtetuese të VKM-së nr. 151/2025. Në datën 02.05.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur ndarjen e çështjes dhe shqyrtimin veçmas të kërkesës së kërkueses nga dy shoqatat e tjera, duke vlerësuar se kërkuuesja, qendra CLE, nuk legjitimohet *ratione personae* (shih paragrafin 12 të vendimit). Kjo, pasi, sipas shumicës, qëllimi i kërkueses është tepër i gjerë dhe i hartuar në terma të përgjithshëm, dhe se ajo nuk ka paraqitur asnjë provë ose argument në drejtim të veprimtarisë së saj të lidhur me kategori të posaçme ose të drejtat kushtetuese që synon të mbrojë përmes ankimit kushtetues individual dhe as të mënyrës së përfaqësimit të kategorive të prekura nga zbatimi i aktit të kundërshtuar. Po kështu, sipas shumicës, kërkuuesja nuk ka arritur të provojë në terma konkretë as ushtrimin e veprimtarisë në drejtim të mbrojtjes gjyqësore të kategorive të subjekteve, të drejtat e të cilave ajo synon të mbrojë ose të përcaktojë ndikimin dhe cenimin konkret të të drejtave të tyre nga zbatimi i aktit të kundërshtuar në drejtim të pasojave të drejtpërdrejta e reale ose potenciale të shkaktuara këtyre interesave. Në përfundim, shumica ka vlerësuar se veprimtaria e kërkueses nuk rezulton të jetë e lidhur mjaftueshmërisht me normën e kundërshtuar, në një masë të tillë që të legjitimojë atë në kërkesën e saj, sipas objektit (shih paragrafin 11 të vendimit).

3. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, pasi në vlerësimin tim ai është rrjedhojë e interpretimit të ngushtë dhe formal që rrudh hapësirën qytetare në një situatë kur në Shqipëri ekziston nevoja për të gjallëruar shoqërinë civile për shkak të rolit thelbësor që ajo luan si rojtar publik në mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe të lirive e të drejtave themelore. Për më tepër, në kushtet e aspiratave të vendit tonë për t’u integruar në Bashkimin Evropian, roli i shoqërisë

civile duhet të përforcohet dhe të inkurajohet në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e saj në politikat sociale. Kjo përbën edhe një nga gjetjet kryesore të raportprogresit të Bashkimit Evropian ku së fundmi është vënë theksi në mjedisin sfidues ku veprojnë organizatat e shoqërisë civile dhe në nevojën për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në konsultimin e çdo ndryshimi të kuadrit ligjor bazuar në një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës.¹ Në këtë këndvështrim, çmuj se vlerësimi i shumicës për legjitimitimin e kërkueses, sjell, si pasojë, dekurajimin dhe shmangien e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në shoqëri dhe nismat publike, për shkak të nxitjes së barrierave dhe formalizmave të tepruar në pranimin e shprehjes së interesit të tyre.

4. Sikurse kam shprehur edhe më herët, organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kyç, si shprehje e lirisë kushtetuese të organizimit të qytetarëve në demokratizimin e shoqërisë. Ato monitorojnë vullnetarisht mënyrën sesi ushtrohet pushteti publik dhe krijojnë forume për debatimin e politikave publike dhe shpërndarjen e informacionit për çështjet që prekin interesat e grupeve të ndryshme ose të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë mënyrë, veprimtaria e organizatave civile është e domosdoshme në funksionimin e shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nxit debatin publik dhe ndërgjegjëson qytetarët për çështje me interes të gjerë, por ato shërbejnë edhe si mekanizma të dialogut konstruktiv midis qytetarëve dhe autoriteteve publike. Organizatat e shoqërisë civile, duke qenë të pavarura, janë partnerë jetikë të shtetit demokratik. Ato kanë aftësinë që me veprimtarinë e tyre vullnetare dhe të pavarur ta bëjnë shtetin në të gjitha nivelet më të përgjegjshëm, llogaridhënës, gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke i forcuar atij legjitimitetin dhe besimin e qytetarëve.

5. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, vë në dukje se kërkuësja ka pretenduar se akti i kundërshtuar cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike, lirinë e shprehjes, të shtypit dhe së drejtës për informim, si dhe parimin e shtetit të së drejtës, të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme. Për sa i takon qëllimit të veprimtarisë së kërkueses, rezulton se ajo synon fuqizimin ligjor të qytetarëve për të njohur, kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike parësore, dytësore etj., të shërbimeve ligjore dhe financiare, pjesëmarrjes në procedurat e konsultimit të legjislacionit, organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve dhe hartimin e publikimin e studimeve në fushën e drejtësisë etj. Po kështu, në drejtim të objektit dhe fushës së veprimtarisë evidentohen edhe të drejtat themelore të njeriut.

6. Në analizë të qëllimit të veprimtarisë së kërkueses, duke mbajtur në vëmendje pretendimet dhe argumentet e paraqitura, çmuj se akti i kundërshtuar prek atë pjesë të veprimtarisë së kërkueses që synon mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe të qytetarëve. Kjo do të thotë se kërkuësja përmbush kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 49, pikat 3, shkronja

¹ Shih Raportin e vitit 2024 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, datë 30.10.2024 https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf [faqet 4, 24 – 26, 37].

“d” dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000 dhe standardet kushtetuese të elaboruara nga Gjykata për vënien në lëvizje të saj (shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 39, datë 15.12.2023; nr. 37, datë 01.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014; nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese), pasi ka provuar lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar midis objektit të veprimtarisë dhe çështjes kushtetuese të paraqitur për shqyrtim.

7. Në vështrim të sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese, rolin e organizatave civile në shtetin e së drejtës, nevojën për nxitjen e pjesëmarrjes së tyre, qëllimin e veprimtarisë së kërkueses dhe veprimtarinë konkrete të kryer prej saj në raport me pretendimet kushtetuese në çështjen e paraqitur, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se qendra CLE legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, sipas objektit të kërkesës, dhe ajo duhet të kalonte për shqyrtim në seance plenare së bashku me dy kërkuemet e tjera.

Anëtare: Marsida Xhaferllari